



2026 JANAR

Mbrojtja në një muaj

mod.gov.al



A photograph showing four men seated at a long table during a conference. From left to right: a man in a dark suit, a man in a grey military uniform, a man in a dark suit and glasses, and a man in a blue suit. They are all looking towards the right. In the background, the Albanian flag, the NATO flag, and the European Union flag are visible. A screen on the right displays the text 'MBROJTJA' and 'Prioritetet dhe Sfi'.

FAZË E RE E POLITIKËS SË MBROJTJES DHE SIGURISË

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu gjatë një konference për mediat deklaroi se, Shqipëria po hyn në një fazë të re të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes, ku paqja nuk mund të merret më si e mirëqenë, por kërkon investime konkrete në kapacitete reale shtetërore. Duke iu referuar situatës gjeopolitike dhe rolit të Ballkanit, ministri Vengu theksoi se rajoni përballët sot me forma të reja kërcënimesh. Shqipëria, sipas ministrit Vengu, është duke përgatitur edhe Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes.

★★★★★

VENGU: BUXHETI 2026, PAGA MË TË LARTA

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu në një konferencë për mediat detajoi disa nga elementët e buxhetit 2026, që do të jenë në shërbim të modernizimit të Forcave të Armatosura. Ministri Vengu bëri të ditur se pagat e ushtarakëve do të rriten ndjeshëm në mënyrë progressive. “Synimi ynë është që deri në vitin 2029 të arrijmë mesataren e NATO, ndërsa rritja parashikon 60% ÷ 70% për pagat bazë dhe rreth 30% për nivelet e larta të komandimit”, sqaroi Ministri i Mbrojtjes.





MIRATOHET LIGJI PËR IMPORTIN DHE EKSPORTIN E ARMËVE TË ZJARRIT

Kuvendi i Shqipërisë miratoi pas një seance maratonë, me 84 vota pro, 10 kundër dhe asnjë abstenim projektligjin “Për importin, eksportin dhe tranzitin e armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve”. Nisma synon forcimin e kuadrit rregullator të Industrisë së Mbrojtjes dhe rritjen e kontrollit mbi mallrat me përdorim të dyfishtë civil dhe ushtarak. Gjatë prezantimit në seancë plenare, ministri i

★★★★★



MM

345 MILIONË LEKË PËR 15 BASHKI TË PREKURA NGA ZJARRET

Mbi 345 milionë lekë janë akorduar nga qeveria si dëmshpërblim për 15 bashki të vendit që u prekën nga zjarret gjatë sezonit të verës. Bashkia e Krujës përfiton shumën më të madhe të fondeve 146 milionë lekë, e ndjekur nga Gramshi me 86,6 milionë lekë dhe Finiqi me 40 milionë lekë.

★★★★★

mod.gov.al

MOD
MINISTRI E DREKTORAT
DREKTORAT E MOD

DËMSPËRBLIM
PËR BASHKITË
AKTIT NORMATIV
NR.11 DATE 19.1

MALESI E MADHE

HAS

KUKES

DIBER

KRUJE

KAMEZ

PEQIN

LIBRAZRI

GRAMSHI

RROGOZHINE


TEPELENE

FINIQ

DROPUK

DELVINE

TOTALI
345,819,120



RRITEN FONDET PËR MBROJTJEN CIVILE

Qeveria shqiptare, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes ka rritur mëshitetjen financiare për mbrotjen civile. Në zbatim të ligjit “Për buxhetin e vitit 2026”, janë parashikuar: 1 mld lekë në formën e transfertës së kushtëzuar, e cila ndahet në 500 mln lekë për investime si dhe 500 mln lekë për kompensimin e qytetarëve të prekur në raste zjarresh apo përmbytjesh. 1,5 mld lekë janë parashikuar për financimin e projekteve që lidhen me parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe 300 mln lekë për financimin e projekteve për digat dhe rezervuarët.

★★★★★

A photograph showing Minister Pirro Vengu, wearing a dark blue jacket and glasses, inspecting military facilities in Mengël. He is surrounded by military personnel in camouflage uniforms. In the background, a person in a red jacket with a white cross on the back is visible. The scene is set outdoors with mountains in the distance.

MINISTRI VENGU INSPEKTIM NË MENGËL

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, i shoqëruar nga kryetari i Bashkisë së Elbasanit Gledian Llatja inspektoi mjediset e njësisë së Batalionit të Emergjencave Civile në Mengël të Elbasanit, një nga bazat me përdorim të dyfishtë, që po forcohen si pjesë e rrjetit kombëtar të sigurisë dhe reagimit ndaj fatkeqësive natyrore. Gjatë inspektimit, ministri Vengu theksoi se Mengëli është pjesë integrale e rrjetit të bazave që synohet të bëhen gjithnjë e më funksionale, me kapacitete të shtuara njerëzore dhe logjistike.

★★★★★



MINISTRI VENGU PRITI HOMOLOGUN BELG

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu priti në një takim homologun e tij belg Theo Francken, i cili zhvilloi një vizitë zyrtare në Tiranë. Gjatë takimit, dy ministrat diskutuan mbi forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe në fushën e Mbrojtjes, me fokus të veçantë në stërvitjet e përbashkëta, rritjen e ndërveprimit operacional dhe zhvillimin e bashkëpunimit në industrinë e mbrojtjes. Këto elemente konsiderohen thelbësore për rritjen e kapaciteteve mbrojtëse dhe për forcimin e sigurisë rajonale.

★★★★★



INTERES NË RITJE PËR FORCAT E ARMATOSURA

Në fazën e parë të rekrutimeve për vitin 2026 janë regjistruar 343 aplikime, duke vijuar trendin pozitiv të vitit 2025. Rritja e pagave, shërbimi si karrierë dhe rikthimi i dinjitetit po shtojnë interesin dhe besimin e të rinjve për uniformën dhe shërbimin ndaj atdheut, ndërsa vijon puna për rritjen në sasi dhe cilësi të komponentit aktiv në Forcat e Armatosura.

★★★★★

mod.gov.al

MM



MINISTRI VENUGU INSPEKTOI KOMPLEKسين STËRVITOR NË BIZË

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu inspektoi kompleksin stërvitor në Bizë/Pajet, një investim strategjik që synon modernizimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të trajnimit të Forcave të Armatosura si dhe zhvillimin e stërvitjeve ndërkombëtare sipas standardeve bashkëkohore të NATO-s. Gjatë inspektimit, ministri Vengu u njoh nga afër me infrastrukturën dhe kapacitetet funksionale të kompleksit.

★★★★★

mod.gov.al

MM



KUNDËRADMIRAL ARSEN MULLAJ MERR DETYRËN E KOMANDANTIT TË FD

Kundëradmiral Arsen Mullaj mori zyrtarisht detyrën e komandantit të Forcës Detare, pas dekretimit nga presidenti i Republikës. Ai zëvendëson në këtë detyrë nënadmiral Adnand Agas-tra, i cili përfundon mandatin e tij në krye të Forcës Detare. Në ceremoninë e dorëzimit të detyrës mori pjesë ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, i cili vlerësoi ndërrimin e komandës si pjesë të vazhdimësisë profesionale dhe forcimit të lidërshiptit në Forcat e Armatosura.

★★★★★

mod.gov.al

MM



FORCAVE TË ARMATOSURA U SHTOH TRE GJENERALË TË RINJ

Niveleve drejtuese të Forcave të Armatosura iu shtuan tre gjeneralë të rinj brigade: Razije Mehmeti, Fatmir Neziraj dhe Edmond Voci. Tre profesionistë me rrugëtime të veçanta në shërbim të uniformës dhe Atdheut marrin përgjegjësi të reja në drejtimin e Forcës, me synimin për të kontribuar me përkushtim

★★★★★

mod.gov.al

MM